



Pranuar - Prmijeno Më/Dana <i>14.03.2013</i>			
Nr. l organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vendimet
<i>01-013/20</i>			

Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 10 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr 04/L-144 dhe nenit 35.2 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 11.03.2013, aprovon këtë:

### V E N D I M

PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PALUAJTSHMËRISË (TOKË) NË PRONËSI SHOQËRORE PRONË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË NË SHFRYTËZUESIN E PËRKOHSHËM BASHKËSIA ISLAME NË VITI PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE NË FSHATIN DORBESH

#### Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, bënë caktimin dhe bartjen administrative të së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme (tokës) e cila evidentohet në ngastrën kadastrale nr 574-1, lloji i pronës Parcelë, zona u/r Unknoën, vendi i quajtur "Rosulja utrina", në sipërfaqe prej 1500m2 Zona Kadastrale Drobesh, nga pronari i më parshëm P.SH. Shkolla Fillore "Dëshmorët e Vitisë" – Viti, në bartësin e ri shfrytëzuesin e përkohshëm Bashkësia Islame në Viti-Çerdhja e fëmijëve në fshatin Drobesh.

#### Neni 2

Bartja administrative e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme nga neni 1 i këtij vendimi bëhet pa kompensim, duke u bazuar në kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti dhe Pëlqimin e fshatit Drobesh me numër 02-07/1964 të datës 02.11.2011 drejtuar Drejtorisë për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë. e cila do të punon duke zbatuar Ligjet për Çerdhet të Arsimit në Kosovë.

#### Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë, obligohet që të bëjë ndërrimin në regjistrin kadastral në emër të shfrytëzuesit të ri.

#### Neni 4


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

#### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pa miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër
2. Bashkësisë Islame në Viti
3. Arkivit



KRYESUESI I KUVENDIT  
Skenderbe Hebibi

*Skenderbe Hebibi*